

REPUBLIKA E KOSOVES  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN



Pronuar më: 09-01-2019		
Prilijonot: 2019		
Albina Lipjani	Numri E-01	Shifra Dodarak
1-400-1830		



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

*Lipjan, 09.01.2019*

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve të regjistruara.

1. *Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport* u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në *avancimin dhe afirmimin e kulturës në Komunën e Lipjani*.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte në lëmin e kulturës sipas shpenzimeve si në vijim:

Organizimi i ngjarjeve për promovimin e vlerave kulturore, koncerti festiv me rastin e festës së Pavarsisë së Kosovës 17.02.2019.

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në *avancimin dhe fuqizimin e kulturës në Komunën e Lipjanit*.

4. Numri i OJQ-ve që do të mbështeten nga kjo thirrje është një (1) OJQ.

Mjetet do të terhiqen nga kodi Subvencione për entitete jo publike

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 2.000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 2500 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 30.01.2019.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është minimum 1 ditë maximum 1 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e sportit. OJQ duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përpËthje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare ([www.komunaelipjanit-rks.org](http://www.komunaelipjanit-rks.org)).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT  
Rruga „Shqipëria“  
Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [bekim.zaskoku@rks-gov.net](mailto:bekim.zaskoku@rks-gov.net)

Kryetari i Komunës së Lipjanit

z. Imri Ahmeti

